



PROCESVERBAL I/2025

I mbajtur me rastin e mbledhjes së I (parë) për vitin 2025 të Komitetit për Komunitete Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 24.01.2025
Ora : 09:00

Prezentë:

Z. Denis Sofra - Kryesues

z.Nazim Shabanaj

znj.Aferdita Morina

z.Zek Berisha

znj.Melisa Shabanaj

z.Aziz Bytyqi

znj.Dorentina Zenelaj

Të pranishëm tjerë:

Xheladin Sadikaj- Zyrtar për Kthim dhe Komunitete

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore

Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim

Përfaqësues i OSBE-së

Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi z. Denis Sofra cili propozoi këtë:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-6358, të datës 28.01.2022 ;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtëshme të Komunës;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurta të pronës së paluajtëshme të Komunës ;**
- 5. Të ndryshme;**

Takimin e hapi kryesuesi i komisionit Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.E hedh në votim rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Denis Sofra - e hedh në votim pikën 1.

Aprovohet pika 1

Pika 2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-6358, të datës 28.01.2022 ;

Denis Sofra-i njofton me pikën dhe ja kalon fjalën Zyrtarit ligjor.

Avni Bytyqi-Përshendet të pranishmit,besojë që ju tash jeni në rrjedha është fjala për komisionin për ndarjen e bursave,në bazë të rregullores për ndarjen e bursave e kemi obligim që të jemi 5 anëtar në kuadër të këtij komisioni. Njëri anëtar i ekzekutivit ka dalë në pension dhe ne sipas vendimit paraprak jemi të obligum që të zavendojmë dhe ta plotësojm komisionin që në të ardhmen te shqyrtohen aplikacionet të cilat jan për bursa,për nxënësa dhe studenta.Në KPF ky projekt vendim është miratu për Asamble.

Denis Sofra-e hedhë në votim pikën 2.

Aprovohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtëshme të Komunës;

Denis Sofra- i njofton me pikën dhe ja kalon fjalën Zyrtarit ligjor.

Avni Bytyqi-Bëhet fjalë për dy parcela në zonën Agrozona në Samadrexhë, besoj që ju jeni në rrjedha që prej vitit 2015 kjo Agrozonë në Samadrexhë funksionon, dhe Drejtoria për Pronë dhe Kadastër ka bërë

kërkesë që dy parcelat të fillojnë procedurat për të bërë pëlqimin për të udhëhequr procedurat e konkurimit të hapur me qëllim që qytetarë të kenë mundësinë kultivimin e perimëve në sera, këtu ka qenë interesi i drejtorisë dhe i Komunës dhe i Komunës, paraprkishtë kemi marrë pëlqimin e KPF-së dhe vazhdojmë më tutje për Asamble.

Denis Sofra-e hedhë në votim pikën 2.

Aprovohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurta të pronës së paluajtëshme të Komunës ;

Denis Sofra- i njofton me pikën dhe ja kalon fjalën Zyrtarit ligjor.

Avni Bytyqi-Bëhet fjalë për një pjesë të një parcele në Zonën industriale në Shirokë, aty paraprkishtë ka qenë grumbullimi i mbeturinave nga ndërtimet e renovimet e objekteve që ndodhën në territorin e Komunës së Suharekës, mirpo aty ka qenë një kontratë 5 vjeqare dhe ajo kontratë i ka skadur operatorit ekonomik dhe Komuna përsëri ka shprehë gadishmërinë dhe interesimin që të zhvillojë procedurat e një ankandi publik për ta dhënë në shfrytëzim për një afat të shkurtë, dhe kjo periudhë do të caktohet në Asamble se sa do të jetë periudha për shfrytëzimin e asaj parcele, për grumbullimin e mbeturinave nga demolimet, dhe ndërtimet e objekteve që ndodhin në Komunën tonë

Denis Sofra-e hedhë në votim pikën 3.

Aprovohet pika 4

Pika 5. Të ndryshme;

Denis Sofra-isha ndërlidh te puna e bursave, kërkoj nga Komisioni tek qështja e Komuniteteve që i kemi pak në numër, i kemi disa aplikime që janë bërë, kërkoj nga ekzekutivi dhe komisioni ti kenë kushtet dhe kriteret më të ulëta për arsye se po kemi rezultate të cilat nuk po na pëlqejnë.

Avni Bytyqi-Rregulloret dhe vendimet që i miraton Kuvendi i Komunës në Suharekë, asnjëherë nuk pretendim që dikujt të ja lehtëson kushtet dhe kriteret, e dikujtë të ja vështirësojë, rregulloret miratohen për të gjithë qytetarët e Komunës së Suharekës të barbart pa asnjë dallim. Komisioni për ndarjen e bursave për nxënësia dhe studentë ka obligim ligjor që ta respekton rregulloren në përpikmëri qysh jan të paraparaa kushtet dhe kriteret dhe asnjëherë nuk guxojn të bëjë lëshime në asnjë Komunitet, as në aspektin gjinor as fetar as në qështje kombëtare as qështje Komuniteteve pakic apo shumicë.

Aziz Bytyqi-nëse nxënësi i komunitetit pavarësishtë cilit është në mjekësi dhe ka dy prind të cilët nuk punojnë në institucione shtetërore me automatizëm e përfiton bursën.

Denis Sofra-dhe te një pikë tjetër tek qështja e asistencës sociale, e kemi një njoftim, për të gjithë familjet e Komuniteteve si pakic apo shumicë se afati është bërë deri me 31 Janar, për të gjitha ato familje që jan në kushte të rënda ekonomike.

Doruntina Zenelaj-kam dëgju për një rast të martësës së hershme te Komuniteti pakicë, e cila ishte nxënëse e Shkollës “Destan Bajraktari”.

Habibe Bytyqi-Unë marrë përsiper që të marrë informata të sakta.

Takimi përfundoi: 09:20

Procesmbajtësja: Shyqerije Kuqi